



Data: 02.08.2019

Për: \_\_\_\_\_

Nga: Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)  
Kompleksi i Shkollës “Mileniumi i Tretë”  
Isa Kastrati Str. p. n.  
10000, Pristinë, Kosovë

**Kontakti:**

Tel: +381 38 244 257 ext. 146

Email: [stoska@kec-ks.org](mailto:stoska@kec-ks.org)

**Ftesë për Ofertë**

**Furnizimi me materiale didaktike shkollore -SIM 16**

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) ju drejton kompanisë suaj këtë kërkesë për ofertë për furnizimin në vijim:

Nr.	Përshkrimi i furnizimit	Specifikacioni	Sasia
1	Pako shkollore- për parafillorë dhe klasën e 1-rë	Kjo pako përmban 18 artikuj . Lista është e bashkëlidhur në dosjen e tenderit.	500
2	Pako shkollore për klasën 2-5	Kjo pako përmban 17 artikuj . Lista është e bashkëlidhur në dosjen e tenderit.	570
3	Pako shkollore për klasën 6-9	Kjo pako përmban 15 artikuj . Lista është e bashkëlidhur në dosjen e tenderit.	400

Më shumë se një furnizues ose asnjë furnizues mund të zgjidhet si rezultat i kësaj kërkesë për ofertë.

**Kushtet e ofertimit**

1. Ofertat duhet të kenë të përfshirë çmimet **pa TVSH**, si dhe kopjen e dokumentit të regjistrimit të biznesit dhe TVSH-së.
2. Furnizuesi duhet të ofrojë nga një pako mostër për 3 kategoritë e materialit didaktik të cilën së bashku me ofertën duhet ta dërgojë në Qendrën për Arsim të Kosovës e cila do të vlerësohet nga Komisioni për Vlerësimin e Ofertave.
3. Ofertat duhet të jenë valide së paku 90 ditë pas datës së dërgimit.
4. Të gjitha çmimet e ofertuara duhet të kenë të përfshirë transportin ku do të dërgohen në 10 qendra mësimore në 7 komuna të Kosovës (Obiliq, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren dhe Rahovec).
5. Gjithashtu furnizuesi ka për obligim që materialin didaktik për secilën kategori ta futë në çantat përkatëse të secilës kategori para dërgimit të tyre nëpër qendrat mësimore.

## Kushte të përgjithshme

- Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) e mban të drejtën e ndryshimit të sasisë për artikujt e lartpërmendur derisa të merret vendimi përfundimtar.
- Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) e mbështet vendimin e vet në ofertën që i posedon përparësitë më të larta ekonomike siç mund të jetë kualiteti i produktit, përvoja paraprake dhe performanca e mire për punë të ngjashme me KEC, por kriteri kryesor i vlerësimit është çmimi më i lirë.
- Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) e mban të drejtën të refuzoj ndonjë ose të gjitha ofertat e pranuar.
- Ndërhyrja në këtë proces nuk është e lejuar dhe do të rezultojë në diskualifikimin e ofertës.
- Vendimi final, si rezultat i së cilës do të jetë kontrata, nuk do të bëhet përderisa nuk kompletohen të gjitha procedurat interne të KEC-it.
- Ofertat do të vlerësohen nga Komisioni i Prokurimit i Qendrës për Arsim të Kosovës (KEC) në momentin e mbylljes së procesit.
- Njoftimi do të bëhet një javë pas marrjes së vendimit nga Komisioni Vlerësues i Prokurimit i Qendrës për Arsim të Kosovës (KEC).
- KEC do të bëjë transfer bankar në xhironlogarinë e specifikuar nga furnizuesi pas dorëzimit të secilit artikull dhe pranimit të faturës. Pagesa në kesh nuk do të bëhen. Dërgesat e pjesshme dhe pagesat e pjesshme do të pranohen bazuar në sasi të dërguara dhe nevojat e paraqitura.

### Me rëndësi:

**Furnizuesi që aplikon në këtë tender pajtohet që paraprakisht të ofrojë tri mostrat të tri kategorive që specifikohen në dosje të tenderit. Mostrat e ofruara nuk do të kthehen dhe nuk do të paguhen tek Furnizuesi por do të mbahen si dëshmi nga Komisioni për Vlerësimin e Ofertave.**

**Lëshimi i kësaj kërkesë nuk nënkupton vendim për zgjidhje përfundimtare nga ana e KEC si dhe KEC nuk e ka për obligim pagesën e shpenzimeve të cilat janë rezultat i përgatitjes apo dorëzimit të një oferte.**

Ofertat duhet të dërgohen në zarf të mbyllur në Qendrën për Arsim të Kosovës, që gjendet në rrugën Isa Kastrati p.n , Kompleksi i Shkollës “Mileniumi i Tretë”, 10000 Prishtinë, Kosovë.

Afati i fundit për këtë kërkesë për ofertë është **16.08.2019 në ora 16:00**. Çdo ofertë që dërgohet pas afatit të përcaktuar më lartë nuk do të merret parasysh. Në qoftë se keni ndonjë pyetje, ju lutem kontaktoni Qendrën për Arsim të Kosovës, në numrin e telefonit +381 38 244 257 ext. 146 ose përmes postës elektronike në [stoska@kec-ks.org](mailto:stoska@kec-ks.org) ose [info@kec-ks.org](mailto:info@kec-ks.org).



An EU funded project managed by the  
European Union Office in Kosovo

Implemented by:  **KFOS**  
Fondatori i Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Kosovo Foundation for Open Society  
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo



## DOSJA E TENDERIT

**Emri i pakos:** Furnizimi me pako didaktike shkollore

**Numri i referencës:** SIM-16

**Furnizimi me materiale didaktike shkollore -SIM 16**

**Data: 2 gusht 2019**

1. Ftoheni të dorëzoni ofertën tuaj të çmimeve për furnizim me artikujt në vijim (shihni specifikimin e hollësishëm në vijim të kësaj dosje të tenderit):

*Pakoja parashihet të përmbajë mjetet e nevojshme didaktike për mësim për tri kategori të ndryshme të grup moshave të arsimit të obliguar.*

- *Kategoria 1- përfshinë grup moshat parafillorë – 5-6 dhe klasën e I-rë*
- *Kategoria 2- përfshinë grup moshat e klasave 2-5*
- *Kategoria 3 – përfshinë grup moshat e klasave 6-9*

Përshkrimi	Çmimi për pako	Sasia	Gjithsej Euro
<i>Parafillor dhe klasa e 1-rë</i>		500	
<i>Klasa 2-5</i>		570	
<i>Klasa 6-9</i>		400	
<i>Çmimi total i ofertës pa TVSH</i>			

2. Ju duhet ta dorëzoni ofertën për të gjithë artikujt e paraqitur në këtë ftesë. Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) e mbështet vendimin e vet në ofertën që i posedon përparësitë më të larta ekonomike siç mund të jetë kualiteti i produktit, përvoja paraprake dhe performanca e mire për punë të ngjashme me KEC, por kriteri kryesor i vlerësimit është çmimi më i lirë. Ofertuesi duhet të ofrojë kontratat, referencat paraprake për te dëshmuar përvojën e kërkuar.

3. Ofertat duhet të nënshkruhen dhe të vulosen në secilën faqe, të futen në një zarf të mbyllur dhe të vulosur, **së bashku me mostrat për tri kategoritë** dhe të dërgohen në adresën më poshtë:

**Qendra për Arsim të Kosovës, që gjendet në rrugën Isa Kastrati p.n , Kompleksi i Shkollës “Mileniumi i Tretë”, 10000 Prishtinë, Kosovë.**

4. Oferta e juaj e nënshkruar duhet të jetë plotësisht në përputhje me afatet dhe kushtet e bashkangjitura të furnizimit dhe duhet të shoqërohet me dokumentacionin e duhur teknik dhe

katalogun (katalogët), materialin dhe informatat e tjera përkatëse të shtypura për secilin artikull të ofruar në ofertë, nëse kërkohen në afatet dhe kushtet e furnizimit.

5. Afati i fundit për pranimin e ofertës tuaj është: **16 gusht 2019, ora 16:00**

6. Oferta juaj duhet të dorëzohet sipas udhëzimeve në vijim:

(i) ÇMIMET: Çmimet duhet të jepen në euro, **duke mos përfshirë TVSH-në**, përfshirë koston e dërgimit deri tek vendi i destinimit, që është si në vijim:

Organizata dhe adresa për dërgimin e pakove shkollore	Komuna
Syri i Vizionit, Rr. Isa Demaj nr.14, Pejë	Pejë
Nevo Koncepti, Rr. Ali Pashë Gucia, Nr.31	Prizren
SHL-Kosova, Rr. "Gëzim Hamza-Piktori", nr. 96	Rahovec
Balkan Sunflowers Kosova, Lagjja 29, Qendra Mësimore Fidan Lahu	Fushë Kosovë
Balkan Sunflowers Kosova – Ndërtesa Sociale në Plemetin	Obiliq
Balkan Sunflowers Kosova, fshati Plemetin, Qendra Mesimore	Obiliq
Bethany Christian Services, fshati Brekoc- Qendra Mësimore	Gjakovë
RADC, Lagjja e Romëve afër Stadiumit- Qendra Mësimore	Mitrovicë

(ii) VLERËSIMI I OFERTAVE DHE LËSHIMI I URDHËRIT PËR BLERJE (KONTRATA): Ofertat e përcaktuara si përgjegjëse ndaj specifikimeve teknike do të vlerësohen duke krahasuar çmimet e tyre, siç kërkohet në paragrafin e fundit. Do të zgjidhet kompania e cila ofron çmimin e vlerësuar si çmimi më i ulët dhe produktet e së cilës përmbushin standardet e kërkesave teknike.

(iii) VLEFSHMËRIA E OFERTËS: Oferta juaj duhet të jetë e vlefshme për një periudhë 90 ditore nga data e pranimin të ofertës.

(iv) E DREJTA E BLERËSIT PËR TA NDRYSHUAR SASINË NË KOHËN E DHËNIES SË KONTRATËS. Blerësi e rezervon të drejtën për ta rritur ose zvogëluar sasinë e mallrave dhe shërbimeve përkatëse, sipas paragrafit 15 të kësaj FpO-je, dhe pa ndonjë ndryshim në çmimin për njësi ose në kushtet dhe afatet e tjera të FpO-s/ofertës. Rritja ose zvogëlimi mund të bëhet deri në 15% të çmimit të përgjithshëm të ofruar.

7. Informatat shtesë mund të merren nga: Sofija Toska

E-mail: [stoska@kec-ks.org](mailto:stoska@kec-ks.org)



### AFATET DHE KUSHTET E FURNIZIMIT

8. **Çmimi fiks:** çmimet e cekura në ofertë janë të pandryshueshme dhe fikse dhe nuk mund të përshtaten gjatë realizimit të kontratës.

Gjatë vlerësimit të ofertave, blerësi do ta përcakton çmimin e vlerësuar duke bërë korrigjimet e çmimit të ofruar për shkak të gabimeve aritmetike si në vijim:

Kur ka dallim mes shumës së ofruar në shifra dhe në fjalë, atëherë shuma e dhënë me fjalë do të mbizotërojë;

- (a) Kur ka dallim mes çmimit për njësi dhe shumës totale të vijës për një artikull që rezulton prej shumëzimit të çmimit për njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojë çmimi për njësi ashtu siç është ofruar;
- (b) Nëse ofertuesi refuzon ta pranojë korrigjimin, atëherë do të refuzohet oferta e tij.

11. **Orari i dërgesave:** Dërgesa duhet të kryhet në bazë të orarit të Urdhrit të blerjes (kontratës). Ju lutem shkruani numrin e ditëve që ju nevojiten për te kryer dorëzimin e mallrave në adresat e përcaktuara në paragrafin 6 (i) të formularit të tenderit. Më duhen \_\_\_\_\_ ditë për t'i dërguar artikujt prej datës së nënshkrimit të kontratës. Duhet të keni parasysh se maksimumi i ditëve për nevoja të projektit është **15 ditë** pas nënshkrimit të kontratës.

12. **Pagesa** e faturës do të bëhet pas dërgesës së mallrave.

**Pagesat në avans nuk janë të lejuara.**

13. **Udhëzimet për paketim dhe etiketim:** Artikujt duhen të mbështjellën me material sigures ashtu që të mos dëmtohen gjatë transportit dhe shkarkimit ose lëshimit në funksion.

15. **Specifikimet e kërkuara teknike**

- i. Përshkrimi i përgjithshëm
- ii. Hollësitë specifike dhe standardet teknike

Furnitori konfirmon përputhjen me specifikimet e mëposhtme (në rast të devijimeve, furnitori duhet t'i cekë të gjitha ato).

Specifikacioni i pakos:

<b>Përshkrimi i përmbajtjes shkollore për nxënësit parafillorë 5-6 dhe nxënësit e klasës 1</b>					
<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i mallit</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi për njësi</b>	<b>Gjithsej</b>
1	Lapsa të thjeshtë HB Nr.2	copë	5		
2	Goma	copë	2		
3	Mprehëse e lapsave (metalike)	copë	1		
4	Plastelinë (set 12 ngjyra)	copë	1		
5	Ngjyra të drurit të gjata (set 12 ngjyra)	copë	1		
6	Ngjyra të qiriut (pastel 12 ngjyra)	copë	1		
7	Bllok vizatimi 2	copë	2		
8	Fletore A5 me katror 80gr.40 faqe (80 fletë)	copë	4		
9	Fletore A5 me vija të ngushta 80gr.40 faqe (80 fletë)	copë	4		
10	Fletore A5 me vija të gjëra 80gr.40 faqe (80 fletë)	copë	2		
11	Fletore A5 pa vija 80gr.40 faqe (80 fletë)	copë	1		
12	Numëratore (plastikë)	copë	1		
13	Shkopinj për numërim (plastikë, 100 shkopinjë)	copë	1		
14	Fotrollë për lapsa (e përshtatshme për të dy gjinitë)	copë	1		
15	Set me trekëndësha, vizore (plastikë)	copë	1		
16	Ngjitës letre (te lëngshëm) (10 gram)	copë	1		
17	Gërshërë të vogla	copë	1		
18	Çantë shkolle (të përshtatshme për këtë moshë) dhe duhet të jetë e përshtatshme për dy gjinitë (unisex)	copë	1		
<b>Gjithsej Pako</b>					



<b>Përshkrimi i përmbajtjes shkollore për nxënësit e klasave 2 - 5</b>					
<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i mallit</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi për njësi</b>	<b>Gjithsej</b>
1	Lapsa të thjeshtë HB Nr.2	copë	5		
2	Goma	copë	2		
3	Mprehëse e lapsave (metalike)	copë	1		
4	Plastelinë (set 12 ngjyra)	copë	1		
5	Ngjyra të drurit të gjata (set 12 ngjyra)	copë	1		
6	Ngjyra të qiriut (pastel 12 ngjyra)	copë	1		
7	Bllok vizatimi 4	copë	2		
8	Fletore A/5 me katror 80gr.40 faqe (80 fletë)	copë	5		
9	Fletore A/5 me vija 80gr.40 faqe (80 fletë)	copë	5		
10	Fletore A/5 pa vija 80gr.40 faqe (80 fletë)	copë	2		
11	Numëratore (plastikë)	copë	1		
12	Tabelë shumëzimi dhe pjesëtimi (Letër e plastifikuar A4 me ngjyra)	copë	1		
13	Fotrollë për lapsa (e përshtatshme për të dy gjinitë)	copë	1		
14	Set me trekëndësha, vizore (plastikë)	copë	1		
15	Ngjitës letre (te lëngshëm) (10 gram)	copë	1		
16	Gërshërë të vogla	copë	1		
17	Strajcë (material tekstil) me madhësinë e duhur dhe kualitative për ti vendosur materialet didaktike sipas rregullave të dukshmërisë së BE-së. Strajca të ofertohej pa logo. Shih ilustrimin më poshtë.	copë	1		
<b>Gjithsej Pako</b>					

**Përshkrimi i përmbajtjes shkollore për nxënësit e klasave 6 - 9**

Nr.	Përshkrimi i mallit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Gjithsej
1	Fletore A5 me katror 80gr.40 faqe(80 fletë)	copë	5		
2	Fletore A5 me vija 80gr.40 faqe(80 fletë)	copë	5		
3	Fletore A5 pa vija 80gr.40 faqe(80 fletë)	copë	2		
4	Fletore A4 me katror 80gr.40 faqe(80 fletë)	copë	1		
5	Fletore A4 me vija 80gr.40 faqe(80 fletë)	copë	1		
6	Fletore A4 pa vija 80gr.40 faqe(80 fletë)	copë	1		
7	Bllok vizatimi 5	copë	2		
8	Set me ngjyra të ujit me brushe (12 ngjyra)	copë	1		
9	Set me tempera (12 ngjyra)	copë	1		
10	Set me trekëndësja, vizore & kompas	copë	1		
11	Kimika me ngjyrë të kaltër	copë	5		
12	Laps teknik 0.5 me një kuti me maja rezervë	copë	1		
13	Lapsa të thjeshtë HB Nr.2	copë	2		
14	Ngjitës letre (i lëngshëm) 10 gram	copë	1		
15	Strajcë (material tekstil) me madhësinë e duhur dhe kualitative për ti vendosur materialet didaktike sipas rregullave të dukshmërisë së BE-së. Strajca të ofertohet pa logo. Shih ilustrimin më poshtë.	copë	1		
<b>Gjithsej Pako</b>					

Ilustrim i strajcës sipas rregullave të dukshmërisë së BE-së :







16. Dështimi në përmbushje të kontratës: Blerësi mund ta anulojë urdhrin për blerje nëse furnitori nuk i dërgon mallrat në përputhje me afatet dhe kushtet e lartshënuara, përkundër njoftimit paraprak prej 7 ditësh, të dhënë nga blerësi, pa shkaktuar ndonjë obligim ndaj furnitorit.

*(Të plotësohet nga kompania)*

<b>Nr. i ofertës</b>	SIM-16
<b>Emri i kompanisë</b>	
<b>Nr. Fiskal</b>	
<b>Adresa</b>	
<b>Emri i personit përgjegjës nga kompania</b>	
<b>Data e ofertimit</b>	
<b>Kontakti (tel)</b>	
<b>Emali</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	

